

FATMIRA MUSAJ

**SULEJMAN DELVINA NË ZHVILLIMET POLITIKE
TË VITEVE 1923-1924**

Në zhvillimet politike në vitet 1923-1924, Sulejman Delvina, ashtu si dhe më parë, mbeti një figurë e rëndësishme e politikës shqiptare.

Në veprimtarinë qeverisëse të 10 muajve të parë të fillimit të vitit 1920, i mbështetur nga kabineti i tij, realizoi vendimet e dala nga Kongresi i Lushnjës, siguroi tërësinë tokësore të vendit dhe i riktheu atij pavarësinë, u hapi rrugën zhvillimeve të brendshme në fushën politike, ekonomike, shoqërore e arsimore. Kështu, ai në prill të vitit 1920, do të paraqitej përpara këshillit kombëtar ku do të raportonte për realizimet e qeverisë si dhe do të shtronte programin për të ardhmen. Me këtë përkushtim ai do të vazhdonte të udhëhiqte zhvillimet e vendit. Në fund të vitit 1920, S. Delvina do të mbështetë lëvizjen për mbledhjen e Asamblesë Kushtetuese. Kështu ai dhe qeveria e tij vendosën që më 14 nëntor të atij viti të zhvilloheshin zgjedhjet për Asamblenë¹. Për shkak të kundërshtive që hasi vendimi nga disa anëtarë të Këshillit të Naltë dhe në radhët e deputetëve të Këshillit Kombëtar, ai paraqiti dorëheqjen e tij e të kabinetit².

Në zgjedhjet e vitit 1921 për në Këshillin Kombëtar, S. Delvina u zgjodh deputet i Gjirokastrës, ku vijoi të jepte kontributin e tij në trajtimin e problemeve me karakter politik, ekonomik, shoqëror që u shtruan në kuvend si dhe në krijimin e miratimin e ligjeve për t'i përqsuar ato me prirjet demokratike të zhvillimit të vendit.

Në gjysmën e dytë të vitit 1923, ai si përkrahës i regjimit republikan, mbështeti lëvizjen politike brenda dhe jashtë parlamentit që kërkonte zhvillimin e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese e cila do të

¹ Sherif Delvina, *Roli i Sulejman Delvinës si kryeministër i Shqipërisë (1920)*, gazeta "Shqip", 20 prill 2008, f. 19.

² *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Toena, Tiranë, 2007, f. 177.

përcaktonte formën e regjimit dhe të miratonte kushtetutën e vendit, detyra që ishin lënë të pazgjidhura në Kongresin e Lushnjës. Përveç këtyre dy arsyeve që ishin të domosdoshme për zhvillimin e shtetit shqiptar dhe të ardhmen e tij, shtysë për këtë lëvizje u bë edhe rritja e autoritetit të Ahmet Zogut, i cili mbante postin e kryeministrit. Shqetësimi kryesor i tyre sipas Sejfi Vllamasit ishte se ai mund të orientonte vendin drejt një regjimi diktatorial³.

Në fushatën për zgjedhje për Asamblenë Kushtetuese që u zhvilluan në tetor-dhjetor të vitit 1923, S. Delvina kandidoi si deputet i opozitës në Gjirokastrë ku dhe fitoi.

Gjatë fushatës së zgjedhjeve elektorale të tetor-dhjetorit të atij viti, S. Delvina bëri pjesë në grupin opozitar të kryesuar nga Fan Noli. Në këto zgjedhje ai u zgjodh deputet i rrethit të Gjirokastrës.

Fitorja e grupit qeveritar u shoqërua me kritika nga opozita për parregullsi si në zhvillimin e zgjedhjeve, në numërimin e votave dhe për një sërë incidentesh që ndodhën, objektiv i të cilave ishte opozita. Për këtë arsye ajo i vazhdoi debatet me frymë kundërshtimi edhe në Asamblenë Kushtetuese, e cila i filloi punimet më 21 janar 1924. Debatet politike midis dy kaheve erdhën duke u acaruar. Mundësive për marrëveshje e kompromis ia zunë vendin krismat e armëve si brenda në parlament dhe jashtë tij, duke patur në objektiv dy figura të rëndësishme të politikës shqiptare që i përkisnin pozitës dhe opozitës, çka thelloi dhe i bëri të pamundur bashkekzistencën e tyre në një tryezë siç ishte parlamenti. Atentati i 23 shkurtit ndaj kryeministrit të vendit A. Zogu, tregoi se institucione të tilla si xhandarmëria, ushtria dhe pushteti gjyqësor ishin kapur nga të dy krahët e politikës, gjë që i pengoi ato në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues dhe çka më keq i pozicionoi përballë njëra-tjetrës. Zhvillimi i ngjarjeve tregoi se situata po dilte jashtë kontrollit dhe vendi po zhytej në anarki. Disa deputetë të opozitës dolën me një deklaratë të cilën ia drejtuan Këshillit të Naltë⁴. Aty ata dënonin aktin e shëmtuar në parlament ndaj kryeministrit dhe shprehën shqetësimin për gjendjen e krijuar. Ky rast, theksonin ata, evidentoi faktin që një pjesë e asamblistëve nuk i kishte besim gjandarmërisë, një tjetër nuk i besonte ushtrisë, një tjetër nuk i besonte gjykatores... Pra, -

³ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë, 2000, f. 371.

⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, f. 218.

vazhdonte deklarata, - është arritur, që këto tri guverna, që së bashku janë të ngarkueme për të ruajtur qetësinë e vendit, nën qeverinë e sotme ato janë anmike njena kundër tjetrës dhe një rrezik për tanë shtetin. Si rrugëzgjdhje të situatës në të cilën gjendej vendi ata propozonin ndërrimin e qeverisë.

Dorëheqja e A.Zogut nga posti i kryeministrit, i hapi rrugë krijimit të qeverisë së re të kryesuar nga Shefqet Vërlaci, në të cilën u përfshinë edhe dy pjesëtarë të opozitës. Kjo bëri të mundur qetësimin e situatës politike dhe vazhdimin e bisedimeve të Asamblesë, e cila vuri në rendin e ditës shqyrtimin e statusit përfundimtar të shtetit dhe të përcaktonte formën e regjimit. Por ngjarjet e prillit, vrasjet e dy turistëve amerikanë, dhe e Avni Rustemit e acaroi përsëri klimën politike në vend. Në këto kushte S.Delvina dhe një pjesë e asamblistëve midis tyre edhe mbështetës të qeverisë, shkuan në Vlorë. Pas ceremonisë mortore të A.Rustemit, ata nuk pranuan të kthehen më në kryeqytet. Kështu largimi i një pjese të mirë të deputetëve në Vlorë, bllokuan veprimtarinë e Kuvendit kushtetues. Ata tashmë nuk do t'i përgjigjeshin kërkesave të qeverisë për t'u kthyer në Tiranë. S. Delvina do t'i bashkohej qëndrimeve të opozitës dhe jo vetëm të saj në veprime të mëtejshme të ndërmarra në qytetin e Vlorës. Ai do të nënshkruante telegrame të njëpasnjëshme drejtuar qeverisë ku shfaqej qëndrimi i opozitës për zgjidhjen e situatës. Kështu së bashku me përfaqësues nga krahina të ndryshme të vendit që morën pjesë në varrimin e Avniut, organizuan në ditët e para të majit një mbledhje, ku i kërkuan qeverisë të vinte para drejtësisë vrasësit e A.Rustemit. Çdo vonesë në këtë drejtim ata e konsideronin si mefshtësi të qeverisë e cila po shtonte dita ditës revoltën e popullit që do të kishte pasoja të përvajtueshme, për të cilat përgjegjësia do i ngarkohej asaj, pra qeverisë. Në të kundërt ajo duhej të tërhiqej. "Në se qeveria nuk ishte e zonja ta mbarojë këtë detyrë elementare, theksonin ata, duhet t'u lëshojë vendin atyre që e meritojnë e që janë të zot të sigurojnë jetesën qytetarëve e mysafirëve të huaj, të venë në veprim ligjet e shtetit"⁵. S.Delvina nënshkroi edhe dy telegrame të cilat iu drejtuan autoriteteve më të larta të shtetit, ku kërkohesh që asambleja të zhvendosej dhe të vazhdonte punimet në qytetin e Lushnjës ose në Shkodër, derisa të sigurohej jeta dhe fjala e

⁵ Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSh), Fondi 23, dos. 29, viti 1924, fl. 5-6.

lirë e deputetëve⁶. Gjithashtu, ata protestuan kundër tolerancës së qeverisë e cila kishte lejuar Ceno bej Kryeziun të shkelte kufirin dhe me mbështetësit e tij po i drejtohej Tiranës. Këtë qëndrim të qeverisë e quajtën si akt antikushtetues dhe antikombëtar.

Kërkesa e opozitës për të zhvendosur Asamblenë nga Tirana në Vlorë, Shkodër, u kundërshtua jo vetëm nga qeveria por edhe nga organe të pushtetit lokal, si nga këshillat bashkiake të Beratit, Krujës, Gjirokastrës etj. Në telegramet dërguar qeverisë ata shprehen kundër veprimtarisë së nisur në Vlorë duke e konsideruar atë të kundraligjshme⁷. Ndërsa këshilli bashkiak i Gjirokastrës i bënte thirrje S. Delvinës që të kthehej në Tiranë dhe të kryente detyrën si përfaqësues i zgjedhur prej tyre⁸. Mirëpo opozita dhe të pakënaqur të tjerë ndaj qeverisë vazhduan presionet ndaj saj. Kështu në maj u larguan nga qeveria dy ministra përfaqësues të opozitës. Kjo e detyroi Shefqet Vërlacin dhe qeverinë e kryesuar prej tij të jepte dorëheqje duke u zëvendësuar me qeverinë e Iljaz Vrionit. Por ndryshimet në qeverisje nuk e zbutën qëndrimin e opozitës, e cila krahas veprimeve legale, tashmë kishte nisur marrjen e masave për organizimin e një lëvizjeje kryengritëse. Pikërisht për këtë qëllim u formua në Vlorë komisioni administrativ i përkohshëm më në krye Fan Nolin. Në këtë komision bënte pjesë edhe S. Delvina. Me autoritetin e tij, siç shprehet Sejfi Vllamasi, ai luajti rol në sigurimin e mbështetjes të ushtarakëve të lartë, të cilët ishin të prirur për të ruajtur asnjëherë në këtë konflikt⁹.

Qeveria, me gjithë masat që mori, nuk arriti të vendoste situatën nën kontroll. Ahmet Zogu, i caktuar si komandant i operacionit ushtarak për të përballuar veprimet luftarake, vlerësoi se qëndresa e mëtejshme do të shkaktonte gjakderdhje midis shqiptarëve, prandaj e pa të udhës që së bashku me mbështetësit e tij të largohej jashtë vendit.

Më 10 qershor forcat opozitare hynë në Tiranë dhe më 16 qershor u formua qeveria demokratike e përkohshme e kryesuar nga Fan Noli. S. Delvina bëri pjesë në kabinetin qeveritar në postin e ministrit të Jashtëm. Më 19 qershor qeveria shpalli programin e saj që përmbante reforma të cilat synonin përmirësimin e gjendjes së popullit, kthimin e rendit e të qetësisë, çarmatimin e përgjithshëm, vendosjen e shtetit ligjor. Në fushën

⁶ *Po aty*, fl. 11.

⁷ *Po aty*, fl. 9.

⁸ *Po aty*, fl. 9, 13; gazeta "Dajti", 21 maj 1924, f.3.

⁹ S. Vllamasi, *vep. përm.*, f. 371.

ekonomike parashikoheshin të merreshin masa për çrrënjosjen e feudalizmit dhe përmirësimin e gjendjes së fshatarësisë e të punonjësve të qytetit, të ndihmohej hyrja e kapitalit të huaj në vend, reforma në administratën e shtetit, riorganizimi i punës në shëndetësi dhe arsim, zgjidhja e reformës agrare në të mirë të fshatarësisë, zgjedhje të reja politike¹⁰ etj.

Programi i qeverisë së Fan Nolit u konsiderua nga të huajt si mjaft ambicioz e i guximshëm për një rinovim shoqëror. Ndaj disa pikave të programit S. Delvina dhe disa anëtarë të tjerë të kabinetit, mbajtën qëndrim kritik dhe nuk u pajtuan gjë që vihet re edhe gjatë veprimtarisë së tij në qeveri. “Sulejman Delvina, nënvizonte ministri italian në Durrës, përfaqëson në gjirin e kabinetit një tendencë të moderuar, të kundërt me projektet e programin e qeverisë, që synonte të ulte klasën e bejlerëve, si dhe ishte kundër lidhjeve me elementët irredentistë, me komitetet maqedonase të lidhur me propagandën e qendrave bolshevike”¹¹.

Në postin e MPJ S.Delvina, bëri përpjekje për të realizuar programin e qeverisë që synonte vendosjen e marrëdhënieve miqësore me të gjitha shtetet në mënyrë të veçantë me shtetet fqinje si dhe të rriste autoritetin e shtetit shqiptar në botë. Për t’ia arritur këtij qëllimi, para qeverisë shqiptare dhe MPJ-së duheshin realizuar disa detyra, si njohja ndërkombëtare e qeverisë demokratike dhe zgjidhja e çështjes së kufijve me Jugosllavinë dhe Greqinë. Në dikasterin që drejtonte S.Delvina bëri përpjekje për të përmirësuar punën e shërbimit diplomatik. Krahas kësaj ai do të ndiqte me vëmendje gjendjen e minoriteteve shqiptare jashtë vendit, veçanërisht minoritetit shqiptar në Greqi.

Në korrik të këtij viti S.Delvina angazhohet në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes çame. Popullsia shqiptare në këto treva, pas nënshkrimit të Traktatit të Lozanës në vitin 1923, rrezikohej të përfshihej në shkëmbimin midis popullsisë greke e turke. Për këtë qëllim ai i drejtoi sekretariatit të Lidhjes së Kombeve një telegram në të cilin përshkruante gjendjen tragjike të popullsisë çame në Greqi, kritikonte punën e dobët të Komisionit Miks, denonconte dhunën që qeveria greke ushtronte për dëbimin e nënshtetasve grekë prej racës shqiptare të vendosur në Greqi, etj. Prandaj ai kërkonte që qeveria greke të respektonte premtimet e bëra para Lidhjes së Kombeve për përjashtimin e shqiptarëve nga shkëmbimi,

¹⁰ *AQSh*, Fondi 688, dos. 219, viti 1924, fl. 1-2.

¹¹ *Po aty*.

në të kundërt, ai i bënte me dije Lidhjes së Kombeve se qeveria shqiptare do të vepronte si ajo greke, pra do të vendose çamët e përndjekur mbi pronat e grekofonëve në Shqipëri¹².

Për të siguruar njohjen e qeverisë në arenën ndërkombëtare dhe për të realizuar një ndihmë financiare aq të domosdoshme për ekonominë e vendit, në gusht të vitit 1924 qeveria vendosi të dërgojë Fan Nolin dhe Luigj Gurakuqin në Lidhjen e Kombeve për të marrë pjesë në Sesionin e V të Asamblesë të kësaj Organizate Ndërkombëtare. Në këtë mbledhje këshilli i ministrave ia ngarkoi detyrën e kryeministrit S. Delvinës për kohën që Noli do të qëndronte jashtë vendit¹³.

Si kryeministër ai e drejtoi veprimtarinë e qeverisë dhe nënshkroi një sërë projektligjesh, vendime, rregullore, etj. Të tilla ishin projektligji mbi rregullimin e eksport-importit të drithërave të bukës, etj.¹⁴ Kujdes të veçantë ai tregoi për ngritjen dhe funksionimin e administratës shtetërore për të cilën S.Delvina nënshkroi vendime dhe miratoi rregulloren përkatëse, futi praktikën e konkursit në përzgjedhjen e nëpunësve të administratës shqiptare. Në këtë kuadër nënshkroi projektligjin për tërheqjen në administratën shtetërore të të diplomuarve në Turqi., të cilët për të fituar këtë të drejtë duhej të paraqitnin diplomën dhe të kishin një përvojë 5 vjeçare në punë. Veçanërisht konkursit duhej t'i nënshtroheshin nëpunësit e financës dhe të doganave¹⁵.

Ai ndiqte me kujdes gjendjen e popullsisë çame të dëbuar me dhunë në Turqi dhe e shtroi këtë problem në këshillin e ministrave ku u vendos që për çamët e mbetur keq në këtë vend, të çelej një kredi prej 5 mijë franga ari për të bërë të mundur kthimin e tyre në atdhe¹⁶. Gjithashtu ai bëri të njohur vendimin e Gjykatës së Hagës që Shën Naumi dhe Vermoshi i mbetën Shqipërisë¹⁷ si dhe vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të shtatorit 1924, që 14 fshatrat e Korçës të përfshiheshin brenda kufirit shqiptar. Kjo u konsiderua prej S.Delvinës si një fitore e politikës së jashtme të shtetit shqiptar dhe njëkohësisht realizim i vendimeve historike të Kongresit të Lushnjës¹⁸.

¹² "Shqiptari i Amerikës", n. 119, 29 korrik 1924, f. 1.

¹³ "Fletorja zyrtare", nr. 32, 30 gusht 1924, f.3.

¹⁴ Po aty, nr. 34, 13 shtator 1924, f.1-3.

¹⁵ Po aty, f.3.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty, nr. 37, f.2.

¹⁸ Po aty, nr. 42, f. 1.

Gjithashtu ai mori në konsideratë kërkesën e fëmijëve të të arratisurve mbështetës të Ahmet Zogut, për mbështetje financiare për të mos penguar vazhdimin e studimeve të tyre në vende të ndryshme të Evropës. Për këtë qëllim, me propozim të tij, këshilli i ministrave në shtator 1924 vendosi t'iu dërgojë secilit 250 napolona ari në vit, shumë që do të nxirrej nga të ardhurat e pasurive të sekuestruara¹⁹.

Vëmendje të veçantë S. Delvina i kushtoi zhvillimit të arsimit. Për këtë qëllim, në tetor 1924, nëpërmjet një urdhërese që u drejtonte autoriteteve civile e ushtarake kërkonte prej tyre të angazhoheshin për të vënë në zbatim ligjin mbi mësimin e detyrueshëm në shkollat fillore²⁰. Po kështu në këtë periudhë ai bëri objekt të mbledhjeve të Këshillit të Ministrave çështjen e emigracionit, të cilën kërkoi që ta vendoste mbi baza ligjore duke i prerë rrugën emigrimit të jashtëligjshëm²¹.

Në gjysmën e dytë të tetorit Fan Noli u kthye në atdhe pa arritur ndonjë rezultat në misionin e tij. Qeveria e gjendur nën trysinë e vazhdueshme të legjitimitetit të saj, ishte kërkuar vazhdimisht nga shtete të ndryshme, por që kishte filluar të ngrihej edhe nga forcat e ndryshme brenda vendit, u detyrua të pranojë zhvillimin e zgjedhjeve politike. Dekreti u firmos dhe u botua në fletoren zyrtare më 13 nëntor 1924, sipas të cilit zgjedhjet do të zhvilloheshin 1 muaj më vonë, në muajin dhjetor. Fushata elektorale do të zhvillohej midis partisë radikale dhe asaj demokrat-nacionale. S. Delvina bënte pjesë në këtë të fundit bashkë me Bahri Omarin, Sejfi Vllamasin, Kol Tromarën, Sotir Pecin etj. Ajo që e dallonte këtë forcë politike nga ajo radikale ishte se ajo pranonte reformën agrare gjë që S. Delvina e kishte shprehur edhe në kohën e qeverisë së F. Nolit, prandaj ajo u mbështet nga bejlerët e mëdhenj të vendit Sh. Vërlaci dhe Toptanasit²². Futja e vendit në zgjedhje dhe legjitimi i pushtetit të forcave kundërshtarë, e shtynë A. Zogun, që në dhjetor me mbështetjen e Jugosllavisë dhe me miratimin e Anglisë dhe të Italisë të niste ndërhyrjen ushtarake në kufijtë veriorë të vendit. Kështu zgjedhjet u shtynë.

Ministrit të Punëve të Jashtme, Sulejman Delvinës, pas kthimit të Nolit iu caktua edhe detyra e zv.ministrit të Luftës. Ai së bashku me anëtarë të tjerë të kabinetit e ndiqte me kujdes situatën dhe diskutuan se

¹⁹ Po aty, nr. 36, 24 shtator 1924, f.1.

²⁰ Po aty, nr.39, 13 tetor 1924, f.1.

²¹ Po aty, nr. 37, f.1.

²² “Dielli”, nr.2804 (347); 24 dhjetor 1924, f.1.

si mund të përballohej ajo. Edhe në këto momente të vështira për qeverinë dhe vendin, ai do të kundërshtonte si ministër i Punëve të Jashtme hapat e hedhura nga qeveria e Nolit për të vendosur marrëdhëniet diplomatike me Bashkimin Sovjetik, duke i detyruar përfaqësuesit e këtij misioni të ktheheshin mbrapsht.

Hyrja e A. Zogut dhe mbështetësve të tij në Tiranë në fund të dhjetorit 1924 e detyroi Sulejman Delvinën si dhe anëtarë të tjerë të kabinetit të largohen drejt Italisë dhe më pas ai do të vendosej në Greqi. Gjendja e tij shëndetësore nuk e lejoi atë të kontribuonte në vitet në vazhdim në interes të vendit. Në vitin 1927, pas shpalljes së amnistisë për të arratisurit politikë nga qeveria e Zogut, ai do të kthehet në atdhe. Për kontributin që ai kishte dhënë në shërbim të shtetit shqiptar, parlamenti i akordoi atij një pension dhe një shumë të hollash plus, me të cilat ai do të përballonte jetesën dhe mjekimin e tij. Pas një sëmundje të rëndë dhe të gjatë, ai ndërroi jetë në vitin 1932, në qytetin e Vlorës²³. Për kontributin e tij në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, në drejtim të konsolidimit të shtetit shqiptar dhe sigurimit të tërësisë tokësore të tij, populli i Vlorës dhe autoritetet e larta të shtetit e përcollën në banesën e fundit me nderime të mëdha.

Politikani S. Delvina, burrë i derës së madhe të Delvinajve, do të mbetet përjetësisht si figura më e rëndësishme në historinë e shtetit shqiptar. Ai diti të bashkëpunojë dhe të bashkërendojë veprimet politike midis forcave të ndryshme dhe popullit të vet, për të përballuar një nga momentet tepër delikate për vendin, siç ishte ai i fillimit të vitit 1920, për t'i rikthyer vendit pavarësinë dhe për t'i siguruar integritetin tokësor të kërcënuar seriozisht.

²³ Revista "Minerva", gusht 1932.